



Njësia Policore e Specializuar e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

Njësia Policore e Specializuar (NJPS) e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) përbëhet nga **105 zyrtarë policorë të dërguar nga Polonia.**

Objektivi kryesor i NJPS-së është që ta mbështesë **stabilitetin e Kosovës** dhe të kontribuojë në **sigurinë** e grave, burrave, vajzave dhe djemve nga **të gjitha komunitetet** në Kosovë.

REAGUESI I DYTË I SIGURISË

NJPS e EULEX-it është **reaguesi i dytë i sigurisë në Kosovë**, si pjesë përbërëse e mekanizmit treshresorë të reaguesve të sigurisë ku Policia e Kosovës është reaguesi i parë i sigurisë, EULEX-i është i dyti, ndërsa NATO/KFOR-i është i treti.



Në rolin e saj si reagues i dytë i sigurisë, NJPS-ja e EULEX-it angazhohet **vetëm me kërkesë të drejtpërdrejtë të Policisë së Kosovës** dhe me qëllim **të uljes së tensioneve dhe rivendosjes së rendit publik**, si dhe **për ta mbrojtur jetën, integritetin dhe pronën** e popullatave të prekura.



Prej muajit qershor 2018 deri më sot, NJPS-ja ka vepruar si reagues i dytë i sigurisë në **dy raste**:

- Më **28 maj 2019**, me kërkesë të Policisë së Kosovës, NJPS-ja e rriti shpeshtësinë e patrullimeve në pjesën veriore të Kosovës për më shumë se një javë, pas një operacioni kundër kontrabandës që u realizua të njëjtën ditë.
- Prej datës **20 shtator deri më 14 tetor 2021**, me kërkesë të Policisë së Kosovës dhe në përputhje me mandatin e EULEX-it si reagues i dytë i sigurisë, NJPS e EULEX-it u zbarkua në Pikë-kalimet e Përbashkëta në Bërnjak dhe Jarinjë me një rol vëzhgimi.

Një **Forcë e Reagimit të Shpejtë** (FRSH) është në gjendje gatishmërie **24 orë në ditë** në Mitrovicë. Koha e reagimit të saj është **15 minuta**.



PATRULLIMET VËZHGUESE

NJPS-ja kryen patrullime ditore vëzhgimi në pjesën veriore të Kosovës.



STËRVITJET PËR KONTROLLIN E TURMAVE DHE TRAZIRAVE



NJPS-ja është duke i mbështetur strukturat e Policisë së Kosovës për kontrollin e turmave dhe trazirave përmes organizimit të stërvitjeve trajnuese në nivele taktike dhe komanduese. Përmes këtyre ushtrimeve, Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i, tre reaguesit e sigurisë në Kosovë sigurojnë **koordinim të lehtë** në rast të një zbankimi të vërtetë.



Prej datës 15 qershor 2018 deri më 3 qershor 2022, NJPS-ja ka marrë pjesë në dhjetë trajnime të përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in, njëmbëdhjetë trajnime me Policinë e Kosovës dhe 62 trajnime me KFOR-in.

AKTIVITETET TJERA



NJPS-ja i ofron **mbështetje operacionale Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës** në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës.



NJPS-ja vijon me **stërvitje të rregullta** për t'i ruajtur dhe zhvilluar më tej aftësitë e saj përmes trajnimeve për qitje, trajnimeve në aftësitë orientuese, trajnimeve për përdorimin e armëve të zjarrit, trajnimeve për përdorimin e pajisjeve me rreze x, trajnimeve taktike luftarake për shpëtimin e jetës, trajnimeve për evakuim mjekësor dhe trajnimeve për përdorimin e forcës.



Më 30 maj 2021, pjesëtarët e NJPS-së ndihmuan **në shpëtimin e një personi të lënduar** i cili ishte zhdukur më 28 maj pasi kishte hyrë në Kosovë me motoçikletë.



Më 22 gusht 2021, pjesëtarët e NJPS-së **e shpëtuan një të ri që po mbytej në ujë.**



Pjesëtarët e NJPS-së **dhurojnë gjak** rregullisht.

Më 14 mars 2022, **EULEX-i përforcoi përkohësisht NJPS-në e tij me një Njësi Rezervë prej 70 xhandarmëve nga Portugalia dhe Franca.** NJPS Rezervë u zbarkua duke iu përgjigjur nevojës së EULEX-it për të pasur forca shtesë në terren dhe në mënyrë që ky Mision të jetë në gjendje t'i mbështesë më mirë homologët e tij kosovarë nëse kjo kërkohet dhe nëse është e domosdoshme, duke e marrë parasysh **mjedisin e sigurisë** në Kosovë dhe situatën e sigurisë në rajon. Gjatë gjithë kohës së zbarkimit të tyre në Kosovë, i cili përfundoi më 15 korrik 2022, **NJPS dhe NJPSR kanë punuar krah për krah për ta përmbushur mandatin e EULEX-it.** NJPS-ja Rezervë ka marrë pjesë gjithashtu në trajnimet e përbashkëta me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in.

